



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Buletini i aktiviteteve për muajin Shtator 2024

01 shtator 2024

Në 26 vjetorin e Epopesë së lavdishme të Vërrinit, nënkryetari Kujtim Gashi, kryesuesja e Kuvendit Komunal, Antigona Bytyqi, zyrtarë e qytetarët u mbledhën sot për t'i kujtuar dhe nderuar dëshmorët e kombit në varrezat e dëshmorëve në Landovicë si dhe në fshatrat Kushnin dhe Lez u nderuan dëshmorët dhe martirët. Duke kujtuar sakrificën e ushtarëve të UÇK-së dhe të popullit në kohët e vështira të historisë sonë, na jep kurajo dhe forcë për ta fuqizuar shtetin tonë, që themelet i ka tek të rënët për çlirim dhe liri. Lavdi dëshmorëve, martirëve dhe heronjve të gjallë!



02 shtator 2024

Fillimi i vitit të ri shkollor është gjithmonë moment i veçantë, që simbolizon një hap para në rrugën e dijes dhe zhvillimit personal. Komuna e Prizrenit do të vazhdojë të investojë në përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe në ofrimin e kushteve sa më të mira për nxënësit dhe stafin mësimor. "Urime dhe suksese të gjithë nxënësve, sidomos atyre të klasave të para si dhe punë të mbarë gjithë personelit të shkollave!" - uroi sot Kryetari Shaqir Totaj.



03 shtator 2024

Punimi i terrenit sportiv dhe rrethojës në SHFMU "Naim Frashëri", Kobaj-Prizren. Projekti synon përmirësimin e infrastrukturës sportive dhe rritjen e sigurisë. Punimet përfshijnë pastrimin, nivelizimin e terrenit sportiv, dhe instalimin e një rrethojës së re për oborrin, duke krijuar kushte më të mira për aktivitetet e nxënësve.



04 shtator 2024

Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Krushë të Vogël. Ky projekt synon ndërtimin e një shkolle të re moderne për nxënësit e Krushës së Vogël. Do të realizohen ndërtimi i strukturës, instalimet dhe pajisjet e nevojshme për të siguruar kushte të mira mësimi dhe siguri.



05 shtator 2025

Projekti i Ndërtimit të Infrastrukturës në fshatin Gjonaj ka filluar:

✓ Asfaltimi i rrugëve të fshatit 🚧

✓ Ndërtimi i trotuareve me gjatësi rreth 1.5 km 🚶♂️🚶♀️

✓ Kubezimi i 9 akseve rrugore 🏠

✓ Ndriçimi publik ? 🌙

Ky investim do të përmirësojë cilësinë e jetesës dhe sigurinë për banorët e Gjonajt!



06 shtator 2024

Ka filluar rrënimi i objektit që ndodhet afër deponisë së mbeturinave në Landovicë, objekt i cili ka lejen e ndërtimit të marrë nga Drejtoria e Urbanizmit, por ka bërë tejkalimin e saj; ky tejkalim do të rrënohet. Ky proces, i cili ka nisur këtë të premte, po kryhet nga Inspektorati i Komunës së Prizrenit. Ftojmë të gjithë qytetarët të pajisen me leje ndërtimi dhe t'i respektojnë lejet me të cilat pajisen; përndryshe, do të jemi të detyruar të veprojmë sipas ligjit për rrënimin e tyre. Faleminderit për mirëkuptimin!



09 shtator 2024

Kryetari Shaqir Totaj, së bashku me Drejtorin e Shërbimeve Publike, Çelë Lamaj, morën pjesë në ceremoninë e lansimit të Raportit të Financiar, pjesë e projektit "Fuqizimi i Veprimit Lokal për Klimën" që komuna ka me UNDP-në. Përveç prezantimit u diskutua për krijimin e mundësive për investime, për forcimin e veprimeve lokale për klimën dhe mekanizmave të financimit që

përfshijnë adresimin e boshllëqeve kyçe në financim, teknologji dhe qeverisje në nivel lokal. Pjesëmarrja e Kryetarit tregon angazhimin institucional për të promovuar veprime të gjelbra dhe qëndrueshmëri mjedisore në komunitetet tona.



KUBËZIMI I RRUGËS DHE INFRASTUKURËS PËRCJELLËSE NË FSHATIN KUSHNIN

Projekti i shtrimit të 16 akseve rrugore me kubëza në fshatin Kushnin, Has është duke vazhduar me intensitet të lartë. Ky projekt synon përmirësimin e infrastrukturës rrugore lokale , duke lehtësuar lëvizjen e banorëve dhe rritur cilësinë e jetesës në zonë.



11 shtator 2024

Komuna e Prizrenit dhe Policia e Kosovës Nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

Sot, Komuna e Prizrenit dhe Policia e Kosovës kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për forcimin e sigurisë publike dhe rendit në qytet.

Me këtë memorandum, Komuna i bartë Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren, të drejtat e plota për monitorimin e sistemit të kamerave të sigurisë që do të instalohen në hapësirat publike të qytetit të Prizrenit.

Kryetari i Komunës Shaqir Totaj dhe Drejtori Rajonal i Policisë, z. Faton Alija theksuan rëndësinë e kësaj marrëveshjeje në rritjen e sigurisë dhe mirëqenies në Prizren.



13 shtator 2024

Kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, priti Jeffrey Bargiel nga programi YTILI i Departamentit të Shtetit të SHBA-ve në një takim njoftues dhe mirëseardhës.

Ata diskutuan për projektin “Student Venture Fund,” i cili synon të mbështesë studentët sipërmarrës në bashkëpunim me Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti.”

Kryetari Totaj vlerësoi mbështetjen e SHBA-ve, duke theksuar rëndësinë e projektit për zhvillimin ekonomik dhe arsimor të rajonit, ndërsa Bargiel shprehu entuziazmin për nxitjen e të rinjve në sipërmarrje dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.



15 shtator 2024

Në Ditën e Dëshmorëve të Prizrenit, sot me përulje e mirënjohje Kryetari Shaqir Totaj bëri homazhe në varrezat e Dëshmorëve në Landovicë, bashkë me nënkryetarin Kujtim Gashi, kryesuesen e Kuvendit Antigona Bytyqi, zyrtarë të ekzekutivit, familje të heronjve, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, veteranë e qytetarë.

Me respekt të veçantë u rikujtua vepra e dëshmorëve të kombit dhe roli i tyre thelbësor në ndërtimin e shtetit të Kosovës.

Lavdi!



16 shtator 2024

Kryetari Shaqir Totaj, së bashku me drejtoreshën e DKA-së, Luljeta Veselaj-Gutaj, zhvilluan sot takim me drejtorët e shkollave të Komunës së Prizrenit, ku, prezentë ishin edhe zyrtarë policorë, të udhëhequr nga drejtori rajonal i Policisë së Kosovës, Kolonel Faton Alija.

Në këtë mbledhje të rëndësishme u diskutua për sigurinë në shkollat e Komunës sonë si dhe për mbarëvajtjen e procesit mësimor gjatë këtij viti shkollor.



17 shtator 2024

Kryetari Shaqir Totaj priti sot përfaqësuesit e Agjencisë Amerikane për Mbrojtjen e Mjedisit (US Environmental Protection Agency) dhe Korpusit të Paqes (Peace Corps) të cilat kanë filluar

bashkëpunim të ri, ku, vullnetarët e Korpusit të Paqes, në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Mal të Zi do të trajnohen në fushën e ambientit dhe ndryshimeve klimatike dhe do të kenë mundësi të implementojnë projekte në këtë fushë, të përkrahura edhe financiarisht nga US EPA.

Gjatë diskutimit për mundësitë e bashkëpunimit, Kryetari Totaj u zotua se Komuna e Prizrenit, krahas përpjekjeve të vazhdueshme për krijimin e Prizrenit të Gjelbër, do t'i përkrahë të gjitha iniciativat për mbrojtjen e mjedisit dhe krijimit të një ambienti të shëndetshëm për të gjithë.



18 shtator 2024

Kryetari Shaqir Totaj priti sot Ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë, Sh.T. Jonathan Hargreaves, me ç'rast e falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme që Mbretëria e Bashkuar i ka dhënë Kosovës për dekada me radhë.

Gjatë bisedës, Kryetari Totaj theksoi rëndësinë e shembullit të bashkëjetesës në qytetin e Prizrenit, që është model për harmoninë ndër njerëzore si dhe e informoi Ambasadorin për pasuritë natyrore dhe kulturore që Prizreni ofron, duke e theksuar diversitetin e tij si një aset të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm.

Me këtë rast, Ambasadori Hargreaves potencoi angazhimin e Britanisë së Madhe për të vazhduar mbështetjen e Kosovës në rrugën e saj drejt integritetit evropian.



19 shtator 2024

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka filluar zbatimin e projektit të rëndësishëm “Hapja e puseve për ujitjen e tokave bujqësore” në Komunën e Prizrenit, që synon ta lehtësoj qasjen në ujë për fermerët dhe ta rrisë cilësinë e sasinë e produkteve bujqësore.



20 shtator 2024

Me një aktivitet të organizuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sot u shënua “Dita pa Makina” që kremtohet në shumë vende të botës, në të cilën qytetarët lëvizin pa makina dhe në vend të tyre ngasin biçikleta, karroca apo edhe ecin.

Kjo ngjarje ndërkombëtare që inkurajon qytetarët të lëvizin pa automjete, promovon një stil jetese më të shëndetshme, aktive dhe rekreative.



23 shtator 2024

Në vazhden e përpjekjeve për modernizimin e shërbimeve në qendrat e shëndetësisë publike në Komunën e Prizrenit, sot u përrua aparati i mamografisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, investim i Drejtorisë së Shëndetësisë, që përkon me fillimin e “Tetorit Rozë,” muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit.

Ky projekt i rëndësishëm për mirëqenien e qytetarëve është metodë kyçe për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit, ndërsa, krahas shërbimeve të specializuara dhe cilësore, kontrollet do të jenë falas për të gjithë.



24 shtator 2024

Të nderuar qytetarë,

Pas përfundimit të të gjitha procedurave të shpronësimit, më 8 Tetor 2024 do të fillojë rrënimi i objektit të ndërmarrjes “Liria,” që gjendet pas Shtëpisë së Bardhë në Prizren (Bazhdarhane), e cila hapësirë do të përdoret për zgjerimin e rrugës.

Ky projekt do ta përmirësojë infrastrukturën rrugore në këtë zonë të rëndësishme të qytetit, me qëllim lehtësimin e trafikut dhe përmirësimin e qasjes për banorët dhe vizitorët.



26 shtator 2024

Drejtorja e Shërbimeve Publike ka iniciuar aksionin për pastrimin e hapësirës ku do të krijohet Zona Industriale - një hap drejtë parapërgatitjeve për funksionalizimin e saj.

Funksionalizimi i Zonës Industriale është një nga prioritetet kryesore të Komunës së Prizrenit, me qëllim krijimin e kushteve optimale për zhvillim ekonomik dhe industrial në vitet në vijim si dhe krijimin e vendeve të punës.



27 shtator 2024

Instituti GAP, në bashkëpunim me Helvetas dhe Projektin për Decentralizimin dhe Përkrahje Komunave (DEMOS), ka publikuar sot një përditësim të shkallës së përmbushjes së premtimeve zgjedhore për kryetarët e komunave për mandatin 2021-2025, i cili përfshin periudhën deri në fund të qershorit 2024.

Sipas të dhënave, nga gjithsej 78 premtime të qeverisjes aktuale lokale në Komunën e Prizrenit, 36 premtime janë përmbushur plotësisht (afër 50%), 20 premtime janë gjysmë të përmbushura (afër 25%), 15 janë në fazën fillestare të realizimit (rreth 16%) dhe 7 premtime ende nuk kanë filluar (9%).

Përveç këtyre premtimeve, Komuna e Prizrenit ka realizuar me qindra projekte të rëndësishme që nuk ishin pjesë e premtimeve elektorale, duke kontribuar kështu në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Ky raport vlerëson përparimin dhe transparencën e komunave përballë qytetarëve dhe përfaqëson një mjet të rëndësishëm monitorimi për angazhimin gjatë mandatit.



28 shtator 2024

Po vazhdojnë punimet për restaurimin e Kullës së Cikajve në fshatin Gjonaj, në kuadër të projekteve që po implementohen nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ky objekt i rëndësishëm i trashëgimisë arkitektonike shqiptare, do të rikthehet në gjendjen e tij të mëparshme që ka për qëllim ruajtjen e vlerave tona historike dhe kulturore.



30 shtator 2024

Komuna e Prizrenit ofron falas shërbimin e Ultrazërit dhe Mamografisë

Me 1 Tetor fillon fushata vjetore, ndërkombëtare, e vetëdijesimit për luftën kundër kancerit të gjirit, ku përmes manifestimeve dhe aktiviteteve të ndryshme të shoqërisë së gjerë sensibilizohet popullata, në veçanti gjinia femërore për kujdes të shtuar për shëndetin.

Duke iu bashkangjitur kësaj fushate, me qëllim të diagnostikimit të hershëm të kancerit të gjirit, Komuna e Prizrenit, përmes Drejtorisë së Shëndetësisë, ofron shërbime adekuate në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë familjare (QKMF), ku shërbimi është falas dhe realizohet me anë të Ultrazërit dhe Mamografit, nga ana e mjekes specialiste të radiologjisë.

Vetëm duke pasur shëndet të mirë, duke u kujdesur për shëndetin, gratë mund ta shfrytëzojnë potencialin e plotë, në përmbushje të detyrave të punës, kujdesin për rritjen e fëmijëve, kujdesin ndaj familjes si dhe për zhvillimin e shoqërisë.

Diagnostikimi i hershëm i kancerit të gjirit SHPËTON JETËN!



01 tetor 2024

Kryetari Shaqir Totaj priti sot përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), agjencisë zvicerane Swiss-Contact dhe Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturorë, për të biseduar për avancimin e projektit për ndërtimin e strukturës dhe teleferikut për ngjitje në Kalanë e Prizrenit.

Studimi i fizibilitetit ka përfunduar, ndërsa, në takimin e sotëm u diskutuan hapat e mëtejshëm për hartimin e projektit të detajuar implementues.

Marrëveshja për këtë projekt buron nga një bashkëpunim tripalësh mes Komunës së Prizrenit, MMPHI-së dhe agjencisë zvicerane Swiss-Contact.

Ky projekt do ta lehtësoj qasjen në Kalanë historike, një nga atraksionet më të rëndësishme turistike të qytetit.



Kabineti i Kryetarit/Njësia për Komunikim me Publikun